

**Motrat e vogla e Jezusit kanë kremtuar më 8 shtator 2009
70-përvjetorin e themelimit të kongregatës së tyre.**

**Në këtë rast motra e vogla që jetojnë në Tiranë na tregojnë
jetën e themeluesës së tyre, motrës së vogël Madëlenë.**



**«Jam e sigurt që mund të ekzistojë një miqësi e vërtetë, një dashuri e thellë
mes njerëzve që nuk kanë të njëjtën fe, të njëjtën racë
dhe që nuk janë të të njëjtit vendi»**

(motra vogël Madëlenë e Jezusit)

Madëlenë Hutin lindi në Paris më 26 prill 1898. Qysh kur ishte fëmijë Madëlenë ka pasur dëshirë t'ia dhurojë jetën e vet Hyjit. Babai i saj i ka përçar dashurinë e tij për Afrikën dhe arabët. Në vitin 1921 me një emocion të thellë zbulon Charl dë Fukonë (Vëlla Sharlin e Jezusit) falë biografisë së shkruar nga René Bazin. Në të gjen krejt idealin e saj të ëndërruar prej kohësh: «Jezusin dashuri – Ungjillin e jetuar».

Është e sigurt se Zoti po e thërret për t'u bërë njëra prej motrave të vogla, aq të dëshiruara nga Vëlla Sharli i Jezusit. Edhe pse kjo udhë dukej absolutisht e pamundur, sidomos për shkak të shëndetit, por me besimin e çmendur në **«Jezusin, Zotin e të pamundurës»**, i lutet Zotit çdo darkë, për të shpejtuar nisjen e saj për në Afrikën e Veriut.

Në vitin 1935 u sëmur nga një artrit deformues. Sëmundja u zhvillua me të shpejtë dhe diagnoza është: brenda një kohe të shkurtër mund të mos qëndrojë në shtrat, vetëm – ndoshta – nëse jeton në një vend me klimë absolutisht të thatë, ku nuk bie një pikë shi... si Saharaja!

Për Drejtuesin e saj shpirtëror kjo është shenja e shumëpritur: **«Nisu menjëherë »**, i tha, **«Hyji i mirë do të të marrë për dore dhe ti do ta lësh që Ai të veprojë në këtë mënyrë. Dhe pikërisht se je njerëzisht e paaftë për të bërë diçka po të them me kaq siguri që duhet të nisësh, sepse në rast se ka diçka për të bërë do të jetë Hyji i mirë që do të bëjë gjithçka, pasi pa Të nuk mund të bësh absolutisht asgjë»**.

Krejt themelimi i Kongregatës bazohet mbi këto fjalë profetike.

Më 8 shtator 1939, disa ditë pas shpalljes së Luftës së Dytë Botërore, motra e vogël Madëlenë e Jezusit bën në Algjer Kushtet e saj të para (kushtin e varfërisë, të bindjes dhe të dëlirësisë). **Kjo datë është data zyrtare e themelimit të Motrave të Vogla të Jezusit.**

Në tetor të po këtij viti, lind **Vëllazëria e parë** në **Tugurt**, një oaz në mes të shkretëtirës, 600 km nga Algjeri. Rreth 100 familje nomadësh, nën çadra, të grupuara për shkak të varfërisë së tyre, banojnë rreth oazit.

Në fillim motrat e vogla ishin kushtuar vetëm për popullin mysliman... **por data 26 korrik 1946 shënon një kthesë të fortë.** Motra e Vogël Madëlenë e Jezusit ka sigurinë se **Vëllazëria** duhet t'i shtrihet botës mbarë, të bëhet universale. Themelimet e vëllazërive të vogla shumohen. **“Bëra udhëtimin rreth botës për të sjellë mesazhin e vëllait Charl të Jezusit dhe për të mbjellë bashkësitë e vogla - të ashtuquajtura Vëllazëri - që të dëshmojnë Dashurinë e Zotit për të gjithë njerëzit”.**

Imzot Charles de Provençères, tashmë «ipeshkëv i Vëllazërisë», ndjek me kujdes dhe nxit themelimet e ndryshme të Vëllazërisë dhe përhapjen e tyre: Vëllazëri punëtore, Vëllazëri lindore, Vëllazëri ciganësh, Vëllazëri kushtuar të gërbulurve, Vëllazëri nën çadra me nomadët. Kudo motra e vogël Madëlenë lufton për të marrë lejen që ta vërë Eukaristinë në qendër të çdo Vëllazërie, kudo qoftë banesa e tyre.

“Duhet të kemi një dashuri të veçante për ata që jetojnë në barakë, në çadra, në karvanë...Për këta kam themeluar Vëllazërinë dhe ëndrra ime do të ishte të jetoja gjithmonë me ta...”

Me një “minibus” “Ylli i lëvizshëm” në të cilin kishte marrë lejen për të ruajtur Eukaristinë, motra e vogël Madëlenë, gati çdo verë, duke filluar prej vitit 1956, përshkonte rrugët e Lindjes, përtej “perdes së hekurt”, me përjashtim të Shqipëri, dhe hedh themelet e Vëllazërisë... U afrohet këtyre Vendeve që ndodhen nën regjimin marksist me prirjen e saj të zakonshme: pasionin e Bashkimit, dëshirën për të përhapur përshpirtërinë e Vëlla Sharlit të Jezusit, një miqësi përvujtërisht ofruar të gjithëve. Këto udhëtime vjetore e ndihmojnë të krijojë lidhje miqësore, si edhe të mbështesë motrat e vogla që jetojnë në këto Vende.

Më 8 shtator 1989, Vëllazëria e kremton Jubileun e vet. Pas kthimit nga Bashkimi sovjetik, motra e vogël Madëlenë e Jezusit sëmuret rëndë dhe nuk e merr më veten...

Të hënën, më 6 nëntor, përsëriti disa herë me radhë: **«Hyji im, nuk e kisha menduar se do të ishte kaq e gjatë ...nuk mund të pres më ... nuk mund të pres më».** Mbrëmjen e po asaj dite, me shumë thjeshtësi, arrin te Zoti.

Motra e vogël Madëlenë, që e përmblihte idealin e Vëllazërisë në dy fjalë: «Bashkimi në dashuri», do të ketë qenë pa dyshim e lumtur kur në Meshën e varrimit të saj te “Tre Fontane” «Vëllazëri e Përgjithshme më 10 nëntor, do të jetë e pranishme një turmë e madhe miqsh të çdo feje, të çdo vendi, kombi dhe race. Shenjë e dukshme që kjo grua, plot me dashurinë për Hyjin, ishte bërë dëshmitare e butësisë së Atit për të gjithë bijtë e Tij, përtej të gjitha pengesave.

Po atë mbrëmje u shemb edhe muri i Berlinit; thjesht rastësi apo përkim i mrekullueshëm...!!!



Kiev 1969